

## **Lagështia e ajrit**

Ajri që ndodhet në atmosferë dhe që ne thithim për frymëmarrje, përmban një sasi të caktuar avujsh të tejnxehur uji dhe prandaj ai quhet ajër i lagësht. Sikur ajri të mos ishte i tillë, ne do ta kishim shumë të vështirë të mbijetonim.

Përbërja e ajrit të thatë është: hidrogjen 78.084%, oksigjen 20.948%, dioksid karboni 0.031%, argon 0.934%, gaze të tjerë 0.003% , avull uji, pluhur, tym, mikrobe etj.

Parametrat kryesore që vlerësojnë ajrin e lagur janë:

1. Presioni
2. Temperatura

Në kushtet e presionit atmosferik normal, avujt e ujit në ajër ekzistojnë në një presion parcial të ulët dhe mund të konsiderohen si gaze ideal.

## **Lagështia relative**

Përmbajtja e lagështisë ose lagështia specifike mat sasinë e avujve të ujit të ndodhur në përzierje, por nuk jep treguesin se sa afër gjëndjes së ngopur është përzierja. Lagështia relative e ajrit është një raport midis masës aktuale të avujve të ujit në një volum të dhënë ajri, dhe masës së avujve të ujit që do të jetë e nevojshme për të arritur gjëndjen e ngopur të ajrit në atë volum për të njëjtën temperaturë.

Lagështia relative e ajrit shprehet zakonisht si një përqindje dhe është 0 për ajrin e thatë dhe 100% për ajrin me avuj uji në ngjendje të ngopur. Shumë njërëz ndihen rehat kur lagështira relative është ndërmjet 30 deri në 70% , prandaj një ajër i kondicionuar zakonisht operon në mënyrë që të mbajë lagështinë relative ndërmjet vlerave 40 deri në 50% . Kur ajri është shumë i thatë, lagështira avullon më shpejt nga lëkura e njeriut dhe kjo prodhon një ndjesi të ftohtit edhe pse temperatura është e kënaqshme. Ajri i thatë, gjithashtu heq lagështirën nga hunda, gryka dhe sytë duke shkaktuar irritimin e tyre. Ndërsa, kur ajri është shumë i lagësht, lagështira nuk mund të avullojë lirisht nga lëkura duke shkaktuar mbinxehje të trupit.

## **De-lagështimi**

Temperatura e pikës së vesës është përcaktuar si temperatura në të cilën fillon kondensimi i avullit kur ajri ftohet me presion kostant. De-lagështimi mund të realizohet në dy mënyra kryesore:

- Nga absorbimi fizik duke përdorur ose lëng absorbues ose xhel anidrid silici, klorur litiumi.
- Me ftohjen e ajrit.